

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E
RRETHIT GJYQËSOR
{xxx}
Nr. Regj. 192 Data e
regj. 09.05.2018

Nr. Vend.178
Dt. e vend 18/05/2018

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor {xxx}, e përbërë prej:

GJYQTAR: {xxx}

Asistuar nga sekretar gjyqësor {xxx}, në sot më date 18/05/2018, ora 14 e 00, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit, çështjen penale që i përket:

KËRKUES:

{xxx}, i biri i {xxx} i dtl.08/11/1948, lindur dhe banues në Pogradec, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. {xxx} .

{xxx} i biri i {xxx}, i dtl. 15/02/1974, lindur dhe banues në {xxx}, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. {xxx}.

{xxx}, i biri i {xxx}, i dtl.28/08/2002, lindur dhe banues në {xxx}, përfaqësuar nga prindi i tij {xxx} me prokurë të posaçme nga av. {xxx}

P.TRETË:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {xxx}, përfaqësuar në gjykim nga prokurore {xxx}.

OBJEKTI:

Kërkohet heqja e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”, mbi llogaritë bankare si më poshtë:

- Llogaria nr.00001235176 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}.
 - Llogaria nr.00001447901 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}.
 - Llogaria nr.1 100-285196-001/002/003 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}
- BAZA LIGJORE:** Neni 274/3 i K. Pr. Penale.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, të zhvilluar në prani të prokurores {xxx}, gjykata pasi shqyrtoi aktet që ndodhen në fashikullin e gjykimit

V Ë R E N S E:

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimnr.170, dt.1 1/12/2017 ka vendosur sa më poshtë:

Caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”, mbi llogaritë bankare si më poshtë:

- Llogaria nr.00001235176 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}.
- Llogaria nr.00001447901 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}.
- * Llogaria nr.l 100-285196-001/002/003 pranë Bankës “{xxx}”, në emër të shtetasit {xxx}.

- Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {xxx} për zbatimin e këtyre masave.
- Kohëzgjatja e kësaj mase është e vlefshme 6 muaj që fillon të llogaritet nga momenti i zbatimit të saj.

Kundër këtij vendimi palët e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit {xxx}, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në K.Pr.Penale.

- Dy kopje të këtij vendimi t’i vihen në dispozicion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor {xxx}.

2. Kërkesit kërkojnë heqjen e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”, mbi llogaritë bankare të cituar më sipër, pasi pretendojnë se të ardhurat e tyre janë siguruar nga burime të ligjshme. Kërkesit pretendojnë se janë njohur në mënyrë rastësore me vendimin e mësipërm dhe kanë bërë përpjekje për të siguruar dokumentacionin ligjor që vërteton ligjshmërinë e sigurimit të këtyre parave të depozituara në llogaritë bankare të sipër cituara, pasi këto depozita janë mesë të ligjshme të siguruara me punë të ndërsjeme në shtetin grek dhe me aktivitet privat legal. Kërkesit pretendojnë se kanë siguruar nga autoritetet shtetërore greke gjithë dokumentacionin ligjor, në formën e kërkuar nga ligji, sipas të cilit vërtetohet qartazi të ardhurat e tyre të ligjshme si rezultat i bizneseve shumë vjeçare në Greqi tejkalojnë dukshëm shumën e këtyre parave të llogarive bankare.

3. Kërkesit kanë paraqitur në gjykim dokumentin e lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Athinë, (të noterizuara dhe të përkthyer) e cila ka si person të tatueshëm {xxx}, i cili ka emërtimin “*Të ardhurat e mbetura neto të tatueshme për vitet e mëparshme*” e cila përmbillet me shënimin “*Të ardhurapërfundimtare 207.880Euro*”.

4. Po kështu janë paraqitur dokumenta të tjera në lidhje me të ardhurat e kërkesve, të noterizuara dhe përkthyer dhe më konkretisht:

- Dokument i lëshuar nga Shërbimi i Financave Publike, {xxx}, për vitin financiar 2016, në emër të {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 8.968 Euro dhe për bashkëshorten 1.710 Euro.
- * Dokument i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave, {xxx}, për vitin financiar 2015, në emër të {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 44.290 Euro dhe për bashkëshorten 1.710 Euro.
- * Dokument i lëshuar nga Shërbimi i Financave Publike, {xxx}, për vitin financiar 2014, në emër të {xxx} dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 3.110 Euro dhe për bashkëshorten 1.710 Euro.
- Dokument i lëshuar nga Shërbimi i Financave Publike, {xxx}, për vitin financiar 2013, në emër të {xxx} dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 8.551 Euro dhe për bashkëshorten 0 Euro.
- Dokument i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave {xxx}, për vitin financiar 2012, në emër të {xxx} dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 13.175 Euro dhe për bashkëshorten 0 Euro.
- * Dokument i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave {xxx}, për vitin financiar 2011, në emër të {xxx} Shëmbitrasit dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 13.884 Euro dhe për bashkëshorten 0 Euro.
- Dokument i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave {xxx}, për vitin financiar 2010, në emër të {xxx} dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 14.000 Euro dhe për bashkëshorten 0 Euro.
- * Dokument i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave {xxx}, për vitin financiar 2009, në emër të {xxx} dhe bashkëshortes {xxx} me të ardhura të deklaruara për {xxx} 14.000 Euro dhe për bashkëshorten 0 Euro.

II. VLERËSIMI GJYAKTËS

5. Prokuroria e Rethit Gjyqësor {xxx}, është duke hetuar për veprën penale për të cilën akuzohet shtetasi {xxx} dhe të afermit e tij {xxx}, parashikohet në nenin 287 të Kodit Penal i cili ka parashikuar një listë të gjatë të rasteve, formave dhe mënyrave me të cilat kryhet kjo vepër penale.

6. Gjykata me kërkesën e prokurorisë ka vendosur caktimin e sekustros preventive në referim të nenit 274 të K.Pr.Penale i cili parashikon se:

“Kur ka rrezik që disponimi i lirë një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zgjatë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe të çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal

7. Asetet kriminale, që mund të sekuestrohen në kuadër të një procedimi penal, janë të parashikuar në nenin 36 të Kodit Penal, (dispozitë e cila është ndryshuar me ligjin nr.9086, dt. 19/06/2003, sipas të cilës: *“Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:*

a) *Të sendeve që kanë shërbyer ose që janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale.*

b) *Të produkteve të veprës penale ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentat dhe instrumentat ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjera në pasurinë që rjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryera e veprës penale.*

c) *Të shpërblimeve të dhëna ose të premtuarapër kryerjen e veprës penale.*

ç) *Çdo pasuri tjetër vlera e të cilës i korespondon asaj të produkteve të veprës penale.*

d) *Të sendeve prodhimi, përdorimi, mbajtja, tjetërsimi i të cilave përbën vepër penale edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.*

2. *Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shëndëruar plotësisht ose pjesërisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.*

3. *Nëse produktet e veprës penale janë bashkur me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.*

4. *Konfiskimit i nënshtrohet edhe të ardhurat dhe përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shëndëruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzierë këto produkte në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse edhe produktet e veprës penale.*

8. Vepra penale *“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”*, për të cilën akuzohet shtetasi {xxx} dhe të afermit e tij {xxx}, parashikohet në nenin 287 të Kodit Penal i cili ka parashikuar një listë të gjatë të rasteve, formave dhe mënyrave me të cilat kryhet kjo vepër penale.

9. Kjo veprë penale ka pësuar ndryshime pesë herë, për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe për të reflektuar normat juridike të parashikuara në instrumentat ndërkombëtare, të cilat Shqipëria i ka ratifikuar në kuadër të pjesmarrjes së saj në organizatat ndërkombëtare dhe në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian. Konkretisht është ndryshuar me Ligjin Nr.9086, dt. 19/06/2003, Ligjin Nr.9275, dt. 16/09/2004, LigjinNr.9686, dt.26/02/2007, LigjinNr.23/2012, LigjinNr.14/2013.

10. Kjo dispozitë aktualisht ka këtë përmbajtje: *“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale nëpërmjet:*

- a) *Këmbimit ose transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- b) *fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit zhvendosjes, të pronësisë ose të drejtave që lidhen me pasurinë duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- c) *ftimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë duke e ditur në çastin e marrjes së saj në dorëzim se është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- ç) *Kryerjen e veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave.*
- d) *investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur që janë produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- dh) *këshillimit, nxitjes, ndihmës ose thirrjes publike për kryerjen e secilave veprave të përcaktuara më sipër dënohet me burgim nga pesë deri në 10 vjet.*

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a) *Vepra penale produktet e të cilës pastrohen është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet.*
- b) *Ndjekja penale për veprën, produktet e të cilës pastrohen është parashkruar ose amnistuar.*
- c) *personi që ka kryer veprën penale është i njëjtë me personin që ka kryer veprën nga e cila kanë rrjedhur produktet*
- ç) *për veprën penale nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale ose nuk është dhënë donjë vendimi dënimi i formës së prerë.*
- d) *vepra penale produktet e të cilës pastrohen është kryer nga një person pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme si në shtetin e huaj, ashtu edhe Republikën e Shqipërisë.*

11. Në interpretim të nenit 287 të Kodit Penal, përgjegjësia penale ekziston për këtë veprë penale e mëvetësuar edhe nga vepra penale kryesore nga e cila kanë rrjedhur astetet kriminale. Mjafton që të ketë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personi që ka pasuri e cila buron nga veprimtari të paligjshme, dyshohet se mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale. Niveli i provueshmërisë së veprës penale kryesore, nga e cila dyshohet se kanë ardhur produktet e veprës penale, nuk kërkohet në atë shkallë që kërkohet për veprat penale në përgjithësi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

12. Përgjegjësia penale në bazë të kësaj dispozite, ka disa veçori, që e dallojnë nga përgjegjësia penale për veprat penale të tjera, të parashikuara nga Kodi Penal, të cilat janë pasqyruar në mënyrë më të zgjeruar në Ligjin Nr.10 192, dt.03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit korupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.24/2014 dhe Ligjin Nr.70/2017.

13. Bara e provës për të justifikuar burimin e të ardhurave, i takon të pandehurit ose personit që dyshohet se zotëron pasuritë e paligjshme, në lidhje me pasuritë që dyshohen se janë produkt i veprës penale. Kjo veprë penale dënohet edhe pasi është parashkruar ose është aminstuar vepra penale kryesore. Po kështu vlen të theksohet se përgjësia penale për këtë veprë penale shtrihet jo vetëm te personi që dyshohet se ka kryer ose mund të ketë kryer veprën penale kryesore, por edhe te persona që kanë kryer një nga format ose mënyrat e parashikuara nga nenit 287 i Kodit Penal, për pastrimin e produkteve të veprës penale.

14. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme edhe në rastet kur procedohet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, sipas nenit 3, pika 1, gërma ç, të Ligjit Nr.10 192, dt.03/12/2009. Përsa i përket juridiksionit për gjykimin e masave me karakter parandalues, sipas këtij ligji, referuar nenit 3 dhe 7 të këtij ligji, gjykata me juridiksion të përgjithshëm, dmth gjykatat e shkallës së parë, kanë kompetencë për shqyrtimin e masave parandaluese, me karakter pasuror, që lidhen me veprat penale që nuk janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ose Gjykatës Antikorupsion.

15. Shtetasi {xxx} dyshohet se ka qenë i përfshirë në veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike dhe sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale, pasi nga të dhënat paraprake nuk ka dyshime të forta për kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve, në formën e bushkëpunimit të posaçëm, prandaj gjykata çmon se ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masave preventive. Po kështu gjykata vlerëson se ka edhe kompetencë tokësore në bazë të nenit 77/1 të K.Pr.Penale, pasi dyshohet se kjo veprimtari kriminale mund të jetë kryer jashtë shtetit dhe ky shtetas është ekzekutuar jashtë shtetit në Greqi, në rrethana të tilla, kriteri për përcaktimin e kompetencës tokësore është vendbanimi i të pandehurit ose të arrestuarit, i cili sipas akteve rezulton në qytetin e Pogradecit.

16. Në rastin objekt gjykimi, nga aktet e paraqitura nga prokuroria dhe që ndodhen në fashikullin e gjykimit rezulton se shtetasi {xxx}, është vrarë me armë zjarri në dt.08/10/2017, në Athinë të Greqisë. Nga verifikimet që ka kryer Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, rezulton se ky shtetas dhe të afermit e tij kanë në llogari bankare shuma të mëdha, të cilat nga të dhënat paraprake nuk rezultojnë që të kenë përputhje me të ardhurat dhe fitimet ligjshme të këtij personi, i cili ka qenë emigrant. Këto fakte rezultojnë të provuara me Urdhëm Nr.III, dt. 10/10/2017, dhe Urdhër Nr.112, dt. 10/12/2017, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, të cilat i janë dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor {xxx}.

17. Referuar këtyrë shkresave dhe akteve të tjera që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se në llogaritë bankare të shtetasit {xxx} janë kryer që nga viti 2011 dhe deri në mars viti 2016 transaksione bankare (tërheqje, derdhje dhe shkëmbim valutor) në shuma që variojnë nga nga 38.000 Euro deri 30.000.0000 lekë. Po kështu shtetasi {xxx} rezulton të ketë qarkulluar në Bankën e Tiranës dhe {xxx} shumën monetare që varion nga 13.0000 euro deri në 10.000.000 lekë. Shtetësia {xxx} rezulton të ketë investuar në {xxx} Bank më dt. 15.08.22012 shumën 67.500 Euro dhe në datën 27/09/2012 është debituar kjo llogari në shumën 67.578 Euro. Ndërsa aktive është edhe llogaria bankare e shtetasit {xxx}, i cili është djali i vëllait të shtetasit {xxx} Përsa i përket shkallës së dyshimit të arsyeshëm, gjykata e theksoi dhe më sipër, se nuk kërkohet në atë nivel dhe me prova, sa kërkohet për caktimin e masës së sigurimit personal për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Po kështu nuk kërkohet një shkallë e lartë provueshmërie për veprat penale për të cilat ka dyshime se mund të rrjedhin produktet e veprës penale. Në këto kushte gjykata çmon se për shtetasin {xxx} dhe për të afermit e tij {xxx}, ka dyshime të

arsyeshme dhe të mjaftueshme për të caktuar masën e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” mbi llogarinë bankare, pasi nga të dhënat paraprake se shtetasi {xxx} dyshohet se është ekzekutuar për shkak të “*pazarave të prishura të drogës*”

18. Shumat e mëdhaja të gjetura në llogarinë e tij bankare 38.000.000 Euro/ 30.000.000 lekë, shumat e gjetura tek personat e aferm të tij {xxx} 38.000.000 Euro/ 30.000.000 lekë, {xxx} 13.000 Euro/10.000.000 lekë, {xxx} 67.578 Euro, dyshohet se janë fituar si pasuri e paligjshme nëpërmjet veprimtarisë së trafikimit të drogës.

19. Në lidhje me pranimin e kërkesës të prokurorit edhe për vendosjen e sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të të afermeve të shtetasit {xxx}, të përmendur më sipër gjykata ka me vendimin nr.170, dt. 1 1/12/2017, ka mbajtur parasysh përcaktimet që janë bërë në neni 3, pika 2, gërma (a) të Ligjit Nr.10 192, dt.03/12/2009, sipas të cilit: *Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të rërthortë nga:*

a) personat e afërm (bashkëshorti fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vllëzërit, motrat dhe bashkëjetuesit) për të cilët prezumohet regjistrimi i remë, përveç kur provohet e kundërta.

20. Rezulton se shtetasi {xxx} është babai i {xxx}, ndërsa shtetasi {xxx} është vëllai i {xxx} dhe shtetësia {xxx} është person që ka lidhje të aferta gjinore me {xxx} është nipi i {xxx}. Duke qenë se për të gjithë mund të jenë përfshirë në kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, masa e sigurimit pasuror për sekuestrimin e llogarive bankare duhet të vendoset edhe për këta persona.

21. Kërkuesit të cilët janë persona të aferm në lidhje gjinore dhe krushqie me shtetasin {xxx} i cili është ekzekutuar në shtetin Grek, paraqitën në gjykim dokumentacion të siguruar nga shteti Grek për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumave që ndodhet të depozituara në llogaritë bankare për të cilat është vendosur sekuestrimi dhe për këtë arsye kërkojnë heqjen e sekuestros preventive mbi këto llogari. (*specifikimi i dokumentacionit është bërë në pikën 4 të këtij vendimi*).

22. Gjykata vlerëson se në këtë fazë procedurale që ndodhet, në gjykimin e kërkesave të hetimit paraprak, nuk mund të dalë me përfundime nëse burimet e krijimit të pasurisë janë të ligjshme apo të justifikuara, pasi kjo i përket përfundimit të procedimit, kur prokuroria të përfundojë hetimet ose kur gjykata të japë vendimin përfundimtar.

23. Gjykata çrnon të thekosjë se masat e sigurimit pasuror kanë karakter të përkohshëm dhe kanë qëllim që sendet apo produktet e veprës penale të mos tjetërsohen, fshihen apo asgjësohen nga personat që i zotërojnë ato, derisa të përfundohet procedimi penal. Mungesa e masave paraprake do të sillte humbjen e efektivitetit të procedimit penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pa paragjykuar gjithnjë nëse do të deklarohet fajësia apo pafajësia e personave që u është sekuestruar pasuria.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 274- 276 të K.Pr.Penale, nenit 36, 287 të Kodit Penal dhe neneve 3 dhe 7 të Ligjit Nr.10 192, dt.03/12/2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë”:

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuësve {xxx}. Kundër këtij vendimi palët e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit brenda 10 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall sot në Pogradec, më date 18/05/2018 .

SEKRETARI
Guri SOFI



GJYQTARI
Artan JAHOLLARI



Shenim: Vendimi është ankimuar nga kërkuësit dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit {xxx}, me shkresën nr.192 Prot, date 24.05.2018.

Kancelare
{xxx}



Shenim:Gjykata e Apelit {xxx}, me vendimin Nr.61 date 05.06.2018 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.178date 18.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {xxx} si më poshtë:

Pranimin e kërkesës .

Heqjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” të dhënë me vendimin nr.170 date 11.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {xxx}, mbi llogaritë bankare të kërkuësve si më poshtë:

-Llogari nr.00001235176 pranë bankës “{xxx}” në emër të kërkuësit {xxx}.

-Llogari nr.00001447901 pranë bankës “{xxx}” në emër të kërkuësit {xxx}.

- Llogari nr.1 100-285196-001/002/003 pranë bankës “Tirana bank” në emër të kërkuësit {xxx}

KANCELAR E
{xxx}